

## GJYKATA E QARKUT NË PEJË

KA.nr.426/11

Datë, 24 Janar 2012

Gjyqtari për Konfirmim i EULEX-it, Ingo Risch, në lëndë penale kundër:

**Bekim Nikqi**, i biri i Abdylit dhe nënës Cube Iberdemaj, i lindur me 09 Shtator 1973 në Pejë, me banim në fshatin Qyshk, Komuna e Pejës, i martuar, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Nysret Bici**, i biri i Nazmis dhe Xhezide Dautit, i lindur me 05 Shtator 1986 në Podujevë, me banim në fshatin Godishnjak, Komuna e Podujevës, nuk është i martuar, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Berat Bici**, i biri i Nazmis dhe Xhezide Dautit, i lindur me 20 Mars 1983 në fshatin Godishnjak, Komuna e Podujeves, i martuar, baba i dy fëmijëve, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Agim Berisha**, i biri i Bajramit dhe nënës Fexhrije Ferati, i lindur me 01 Korrik 1969 në fshatin Godishnjak, Komuna e Podujevës, ku edhe banon, i martuar, baba i katër fëmijëve, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Azem Bytyqi**, i biri i Avdylit dhe nënës Gjyzide Kryeziu, i lindur me 22 Mars 1985 në Prizren, me banim në fshatin Zojzë, Komuna e Prizrenit, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Mehdi Bllaca**, i biri i Halitit dhe nënës Shehide Shala, i lindur me 21 Korrik 1957 në fshatin Krushevc, Komuna e Obiliqit, ku edhe banon, i martuar, baba i katër fëmijëve, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Sefedin Bezeraj**, i biri i Smajlit dhe nënës Fatmush Bezeraj, i lindur me 20 Shkurt 1969 në fshatin Rashiq, Komuna e Pejes, i martuar, baba i katër fëmijëve, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Arben Preqi**, i biri i Martinit dhe nënës Nica Preqi – Nokaj, i lindur me 07 Maj 1978 në Gjakovë, me banim në fshatin Fshaj, Komuna e Gjakovës, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

**Zenun Zejnullahu**, i biri Mejdise dhe nënës Shahe Shala, i lindur me 22 Dhjetor 1983 në Viti, me banim në fshatin Ramjan, Komuna e Vitisë, i martuar, baba i dy fëmijëve, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Të akuzuar me Aktakuzë të Zyrës së Prokurorisë Speciale PPS.nr.11/11 të datës 28 Tetor 2011, parashtruar në gjykatë me 25 Nëntor 2011, për veprat penale:

1. *Krim i Organizuar* në kundërshtim me nenin 274 par. 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së
2. *Kontrabandë me Imigrant* në kundërshtim me nenin 138 par. 6 lidhur me nenin 23 të KPK-së

Pas seancës mbi konfirmim të aktakuzës mbajtur me datë 24 Janar 2012 në pajtim me nenin 313 dhe 314 të KPPK-së, në prani të Prokurorit Special Besim Kelmendi, të pandehurve të sipërpërmendur dhe avokateve të tyre mbrojtës, dhe në pajtim me 316 par. 4 të KPPK-së, lëshon këtë

### **AKTVENDIM**

KONFIRMOHET Aktakuza e Zyrës së Prokurorisë Speciale PPS.nr.11/11 e datës 28 Tetor 2011.

Aktakuza bashkë me të gjitha shkresat e dosjes së lëndës i dërgohet Kryetarit të Trupit Gjykses për shqyrtim kryesor, sapo ky aktvendim të merr formën e prerë.

### **Arsyetim**

#### **Prapavija Procedurale**

Me datë 25 Nëntor 2011 Zyra e Prokurorisë Speciale parashtroi Aktakuzën PPS.nr.11/11 kundër të pandehurve Bekim Nikqi, Nysret Bici, Berat Bici, Agim Berisha, Azem Bytyqi, Mehdi Billaca, Sefadin Bezeraj, Arben Preqi dhe Zenun Zejnullahu duke i akuzuar për veprën penale *Krim i Organizuar* në kundërshtim me nenin 274 par. 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe *Kontrabandë me Imigrantë* në kundërshtim me nenin 138 par. 6 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Pas parashtrimit të aktakuzës, gjyqtari për konfirmim, pas vlerësimit të saj, në pajtim me nenin 306 par. 2 të KPPK-së, gjeti se aktakuza është përpiluar në përputhshmëri me nenin 305 të KPPK-së.

Gjyqtari për konfirmim caktoi seancën për datën 24 Janar 2012, për të cilën u ftuan Prokurori Special, të pandehurit si dhe avokatet e tyre mbrojtës. Po ashtu u ftuan edhe palët e dëmtuara për këtë seancë dëgjimore; megjithatë asnjë nga ta nuk u paraqit. Seanca ishte e hapur për publik.

Pasi që Prokurori Publik lexoi aktakuzën dhe pasi që gjyqtari u siguroi se të pandehurit e kishin kuptuar aktakuzën, të pandehurve iu dha mundësia për tu deklaruar si fajtor apo jo fajtor.

Të gjithë të pandehurit u deklaruan se nuk janë fajtor.

Në ankesat e tyre, avokatët mbrojtës kundërshtuan kualifikimin e veprës penale, e në veçanti sa i përket motivit, qëllimit si dhe përshkrimit individual të kontributit të të pandehurve. Për më tepër, ata kundërshtuan në përgjithësi procedurën e dëshmive gjate fazës paraprake si dhe lidhjes së dëshmisë së dhënë nga dëshmitarët.

Të pandehurit mbështetën ankesat e mbrojtësve të tyre.

### **Gjetjet e Gjykatës**

Neni 316 par. 1 i KPPK-së siguron se aktakuza mund të hidhet poshtë në rast se vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale, ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësin penale, është bërë parashkrimi, apo ka rrethana të tjerë që pengojnë ndjekjen penale dhe në rast se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale.

Gjyqtari gjeti se asnjë nga këto rrethana nuk qëndrojnë në procedurën aktuale. Në fakt sipas dosjes së lëndës si dhe dëshmive që përmban kjo dosje, ka dëshmi të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e mirë-bazuar.

Sipas dosjes së lëndës ekziston dyshimi i mirë bazuar se të pandehurit duke punuar së bashku si një grup me strukturë të organizuar janë përfshirë në kontrabandë me imigrant, shtetas të Republikës së Kosovës, përmes territorit të Republikës së Serbisë, Hungarisë, Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë, për në shtete të ndryshme të Evropës. Për këtë shërbim imigrantët duhej të paguanin prej 1.500 deri në 3.000 Euro për person. Nga raportet policore nga masat e fshehta të caktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake mund të supozohet se të gjithë të pandehurit kishin role të ndryshme në aktivitetin e kontrabandimit me imigrant. Duke pasur parasysh se të gjithë aktoret në këtë rast kishin detyra të veçanta dhe se ishin në kontakt të shpeshtë me njeri tjetrin, del se të gjithë pandehurit vepruan si pjesëtar të një grupi të mirë-organizuar.

Prandaj, bazuar në këto rrethana që sigurohen nga aktakuza, gjyqtari për konfirmim gjen se ka dëshmi të mjaftueshme se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, andaj ai e konfirmon aktakuzën.

Sa i përket ankesës së avokateve mbrojtës se prokurori publik ka intervistuar dëshmitarët në mungesë të përfaqësuesve të mbrojtës, gjyqtari për konfirmim i referohet nenit 237 (4) të KPPK-së, i cili i jep të drejtë prokurorit publik për të vendosur se a dëshiron a jo të ftoj të pandehurit dhe avokatet e tyre mbrojtës.


Veç kësaj, gjyqtari për konfirmim vendosi se të gjitha dëshmitë e siguruara gjatë hetimeve janë të pranueshme. Vetëm pjesë nga këto dëshmi mund të shpallen si të

papranueshme, nëse tregohet ndonjë shkelje e caktuar e ligjit në fjalë. Çka nuk ishte një gjë e tillë në këtë rasti.

Prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 316 par. 4 të KPPK-së.

**GJYKATA E QARKUT NË PEJË, KA.nr.426/11, me datë 24 Janar 2012.**

**Gjyqtari për Konfirmim**



**KËSHILLË LIGJORE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.